

# KONTRATA SOCIALE VLORE

## RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2021-SHTATOR 2022

**Viti i III-të i monitorimit**

**PËRGATITUR NGA:**  
QENDRA RINORE E VLORES

## RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

### TË KONTRATËS SOCIALE

### BASHKIA VLORË

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2021 – Shtator 2022

Përgatiti raportin: Qendra Rinore e Vlorës

<b>FALENDERIME .....</b>	<b>4</b>
<b>RRJETI POP .....</b>	<b>5</b>
<b>SHKURTIME.....</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>9</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>10</b>
<b>KONTRATA SOCIALE BASHKIA VLORË .....</b>	<b>11</b>
<b>KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ .....</b>	<b>12</b>
<b>VLERËSIMI I QYTETARËVE .....</b>	<b>13</b>
<b>ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE.....</b>	<b>18</b>
<b>PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE .....</b>	<b>19</b>
<b>PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM .....</b>	<b>22</b>
<b>PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET .....</b>	<b>25</b>
<b>PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK.....</b>	<b>27</b>
<b>PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK.....</b>	<b>27</b>
<b>PRIORITET NR. 6: PASTRIMI .....</b>	<b>28</b>
<b>PRIORITET NR. 7: PASTRIMI .....</b>	<b>30</b>
<b>PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK .....</b>	<b>34</b>
<b>PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK .....</b>	<b>34</b>
<b>PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK .....</b>	<b>35</b>
<b>PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE .....</b>	<b>35</b>
<b>PRIORITET NR. 12: DEMOKRACIA VENDORE .....</b>	<b>36</b>
<b>REFERENCA .....</b>	<b>37</b>
<b>ANEKS .....</b>	<b>38</b>

## Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë periudhës Shtator 2021 - Shtator 2022, dëshirojmë të falenderojmë në radhë të parë qytetarët dhe të rinjtë që ishin pjesë proaktive e këtij monitorimi, mediat lokale dhe sociale që veprojnë në qytet, bashkinë Vlorë me drejtoritë e institucionet e varësisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Një falenderim shkon dhe për anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët kanë kontribuar për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të ngjashme të monitorimit në bashki të tjera ku rrjet punon.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjetit POP.

## Rrjeti POP

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të programit të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

### Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

*Ky raport është përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të projektit dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy.*

***Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e Qendrës Rinore Vlorë.***

## Shkurtime

POP	Përballja e Ofertave Politike
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
Nj.A	Njësi Administrative
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
U.K Vlorë	Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a.
OPIC	Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
NED	National Endowment for Democracy
VYC	Qendra Rinore e Vlorës
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak
SH.A.U.K	Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
MIM Vlorë	Ndërmarrja Bashkiake për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NSHP	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

## Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. **Gjatë vitit 2019** janë hartuar kontratat sociale për **9 bashki** (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës **shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë**, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga **Olof Plame International Centre (OPIC)** dhe **National Endowment for Democracy (NED)**.

**Kontrata Sociale në Vlorë<sup>1</sup>** përmban **12 prioritate** që qytetarët e Vlorës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra Rinore e Vlorës (VYC) si anëtare e rrjetit POP, synoi të krijojë dhe mbështesë mekanizma qytetare, në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak, të nisin dialogun dhe të punojnë për realizimin e prioritetëve të Kontratës Sociale.

Qendra Rinore e Vlorës mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Vlorë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e prioritetëve, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale. **Raporti i parë i monitorimit<sup>2</sup>** vlerësoi se rreth **47%** e prioritetëve të **Kontratës Sociale** u realizuan nga Bashkia Vlorë, ndërsa në **raportin e vitit të dytë të monitorimit<sup>3</sup>** Bashkia përmbushi **65%** të kërkesave dhe prioritetëve të qytetarëve.

<sup>1</sup> Kontrata Sociale me bashkinë Vlorë: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

<sup>2</sup> Raporti I vitit të parë monitorues: [https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-POP\\_Bashkia-Vlore.pdf](https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-POP_Bashkia-Vlore.pdf)

<sup>3</sup> Raporti I vitit të dytë monitorues: [https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti\\_POP\\_Bashkia-Vlore.pdf](https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti_POP_Bashkia-Vlore.pdf)

Prioritetet e Kontratës Sociale ofrojnë një mundësi shumë të mirë që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të monitorimit në programet vendore përmes advokimit si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, duke përdorur procesin e **Buxhetimit me Pjesëmarrje** janë një tregues pozitiv i rritjes së **transparencës** dhe **llogaridhënies**.

Për monitorimin e prioriteteve të Kontratës Sociale janë konsultuar gjerësisht qytetarët, grupet e interesit, staf nga bashkia dhe anëtarë të këshillit bashkiak ku disa nga format e ndërveprimit dhe angazhimit përmendim: takime ballë për ballë, kërkesa për informacion dhe peticione qytetare.

Gjetjet dhe rekomandimet e dala nga raportet monitoruese janë bërë pjesë integrale e komunikimeve me të gjithë grupet e interesit, ndërsa Qendra Rinore e Vlorës si anëtare e rrjetit POP, ka ndërmarrë tre fushata advokimi për prioritete konkrete të Kontratës Sociale që janë: i) ndërtimi i rrugës lidhëse në Kërkovë, Nj.A Qendër; ii) ndërtimi i rrugës lidhëse midis Orikumit dhe Kishës së Marmiroit, Nj.A Orikum dhe iii) përmirësimi i shërbimit të transportit urban dhe afishimi i orareve dhe legjendave të linjave të transportit në Bashkinë Vlorë.

**Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, Qendra Rinore e Vlorës pjesë e rrjetit POP kishte si qëllim:**

- Monitorimin e Këshillit Bashkiak dhe veprimtarisë së Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Realizimin e takimeve dhe fokus-grupeve me komunitetin për të matur progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Përgatitjen e raportit të tretë të monitorimit dhe prezantimi i gjetjeve e rekomandimeve në nivel kombëtar dhe atë lokal;
- Raportimi i gjetjeve dhe rekomandimeve;
- Lobimin dhe advokimin për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies;
- Përdorimin e gjetjeve të Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”<sup>4</sup> për angazhimin dhe informimin e qytetarëve;
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

***Raporti më poshtë vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.***

<sup>4</sup> Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022 <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-Studimor-Bashkia-Vlore-2022.pdf>



## Metodologjia

Për të realizuar raportin Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të POP u bazua në hapat si më poshtë:

- U monitorua puna e Bashkisë Vlorë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën shtator 2021 – shtator 2022;
- Kërkesa për informim iu dërgua bashkisë dhe institucioneve të varësisë.
- Monitorim i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak;
- U organizuan takime me staf të Bashkisë Vlorë mbi progresin e prioriteteve qytetare;
- U realizuan takime me anëtarë të komunitetit në Nj.A të Vlorës, që vlerësuan progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Monitorimi i realizimit të buxhetit vjetor dhe prioriteteve të Kontratës Sociale përmes të dhënave të hapura dhe prokurimeve publike;
- Konsultimi i dokumentave dhe strategjive të Bashkisë Vlorë, buxheti afatmesëm dhe ai vjetor, faqja e internetit e Bashkisë, etj;
- Analizim i monitorimit të mediave audio vizive dhe online sipas fushave specifike.

## Përmbledhje Ekzekutive

Kontrata Sociale përben një dokument themelor ku qytetarët dhe bashkia e Vlorës kanë rënë dakord të punojnë së bashku në funksion të zgjidhjes së shqetësimeve dhe problemeve që kanë nevojë për ndërhyrje përgjatë mandatit katërvjeçar. E firmosur prej 2019, mbeten ende pak muaj deri në maj të 2023, që këto prioritete të adresohen për zgjidhje. Monitorimi i progresit të Kontratës Sociale përshkruan zhvillimin infrastrukturor, ekonomik, social dhe shoqëror të bashkisë së Vlorës, ku nga ana e bashkisë mbizotëron optimizmi dhe prezantimi arritjeve ndërsa në krahun tjetër atë të qytetarëve dhe shoqërisë civile ekziston një qasje kritike duke reflektuar pikat e dobëta, punët publike të parealizuar dhe shërbimet e munguara.

Ne jemi të vetëdijshëm që realizimi i prioriteteve të Kontratës Sociale kërkon shumë investime në burime njerëzore por edhe më shumë në burime financiare dhe Bashkia Vlorë me buxhetin vjetor ose afatmesëm që administron, mundësitë i ka të të limituara. Edhe pse Bashkia e Vlorës përballet me shumë sfida për të adresuar zgjidhje te komuniteti i saj, është e rëndësishme të theksojmë se **adresimi i nevojave, diskutimi e monitorimi** i tyre nga qytetarët dhe stafi i NJ.Q.V është në funksion të ngritjes së urave të komunikimit, duke kuptuar njëri-tjetër për të përmirësuar ndërveprimin midis palëve, duke forcuar në këtë mënyrë edhe demokracinë lokale.

Raporti i Monitorimit të Kontratës Sociale, për periudhën shtator 2021 – shtator 2022, bazohet mbi progresin e çdo prioriteti qytetar që bashkia e Vlorës realizon në punën e saj të përditshme përmes vendimarrjes së Këshillit Bashkiak.

Të 12 prioritetet janë adresuar pjesërisht përmes hartimit të projekteve, planifikimit në buxhetin vendor, projekteve qeveritare dhe ndërmarrjes së nismave e politikave për përmirësimin e tyre. Nga 12 prioritetet e Kontratës Sociale vlerësojmë se nga **47.17%** e tyre që janë realizuar në raportin e parë të monitorimit për periudhën 2019-2020, në **65.25%** për raportin e dytë të monitorimit për 2020-2021, ndërsa për raportin e tretë të monitorimit që përfshin periudhën shtator 2021-shtator 2022, vlerësohet progresi i kontratës sociale në masën **73.75%**.

*Çdo prioritet i Kontratës Sociale përmban një listë të gjatë indikatorësh, ndërsa theksojmë se ka përpjekje pozitive nga Bashkia Vlorë, ku pjesa më e madhe e prioriteteve janë adresuar me investime të drejtëpërdrejta, ndërsa janë hartuar projektet për studimin e fizibilitetit për prioritetet që kanë nevojë për tu mbështetur financiarisht edhe nga qeverisja qëndrore apo donatorë, apo edhe prioritete që nuk kanë nevojë për ndërhyrje financiare, por janë vendosur në agjendën e punës nga Bashkia Vlorë.*

## Kontrata Sociale Bashkia Vlorë

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të garantuar që qytetarët marrin shërbime dhe mbështeten për mirëqenien e tyre. Por janë qytetarët, të rinjtë dhe aktorët e shoqërisë civile, që përmes mekanizmave të ndryshëm qytetarë duhet t'i mbajnë ata përgjegjës në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe shërbimeve lokale.

Në Kontratën Sociale qytetarët kanë dhënë opinionet e tyre për 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor: (i) Shërbimet publike; (ii) Zhvillimi ekonomik vendor; (iii) Dimensioi social dhe (iv) Demokracia vendore. Nga të gjitha këto prioriete, u veçuan si më prioritare 12 prej tyre të cilat u përfshinë në Kontratën Sociale – Vlorë.

Identifikimi i prioriteteve konkrete për çdo njësi administrative të Vlorës, ishte një hap i rëndësishëm për procesin. Në bazë të këtyre prioriteteve, më datë 11.10.2019, mes Bashkisë Vlorë dhe Qendrës Rinore të Vlorës u firmos Kontrata Sociale.

Prej momentit të nënshkrimit, Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të organizatave që implementojnë në rang kombëtar projektin POP – Përballja e Ofertave Politike, është duke monitoruar përmbushjen e prioriteteve dhe pritshmëritë që komuniteti ka ndaj kësaj Kontrate Sociale.

Monitorimi i Kontratës Sociale është një proces sfidues, që ofron mundësi që qytetarët dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të rrisin nivelin e njohurive dhe të informacionit mbi mënyrat si funksionon qeverisja vendore, si merren vendimet e përmes saj kanë mundësi të analizojnë politikat vendore ndërsa përmirësohet dialogu dhe llogaridhënia midis të dyja palëve.

Qendra Rinore e Vlorës gjatë periudhës së monitorimit punoi për të adresuar kërkesat dhe ankesat, por edhe progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale drejt Bashkisë Vlorë apo edhe KB, ndërsa media lokale vazhdon të mbështesë shqetësimet e banorëve përmes kronikave ose lajmeve në mediumet lokale, që prioritetet qytetare të adresohen për zgjidhje. Emisione në TV lokale, radio dhe postime në mediat sociale, informuan qytetarët mbi gjetjet e monitorimit mbi progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

## Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak gjatë periudhës së monitorimit shtator 2021 – shtator 2022, ka realizuar në total **14 mbledhje**, ku janë marrë **102 vendime**. Aktualisht Këshilli Bashkiak numëron **49** anëtarë (**23M/26F**) nga të cilët 47 % janë meshkuj dhe 53% janë femra.

Takime me anëtarë të Këshillit Bashkiak janë zhvilluar përgjatë periudhës së monitorimit, ku përveç intervistave janë paraqitur edhe shqetësimet për progresin e Kontaktës Sociale.

Për periudhën e monitorimit shtator 2021- shtator 2022, Këshilli Bashkiak i Vlorës, përveç vendimeve të sjella për miratim nga administrata e Bashkisë Vlorë, ka miratuar edhe ndryshime e saktësime në *Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak Vlorë*, miratuar në mbledhjen e muajit prill 2022. Ndërsa ka prodhuar dhe miratuar në mbledhjen e muajit janar 2022 Programin e Punës së KB për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe raport të punës për vitin 2021.

Vlerësojmë së është rritur transparenca dhe komunikimi me qytetarët përmes transmetimit direkt të mbledhjeve në faqen e FB dhe publikimit të vendimeve ose dokumenteve që lidhen me punën e Këshillit Bashkiak në faqen e internetit të bashkisë Vlorë. Mbeten ende sfida që duhen kapërcyer, mënyrat si informacionet online paraqiten te qytetarët, faqja e internetit nuk punon rregullisht, ose informacionet që paraqiten janë të vështira për tu gjetur ose për të patur akses.

Nga monitorimi vërehet se vazhdojnë përplasjet midis anëtarëve të KB dhe stafit të bashkisë Vlorë, duke kthyer mbledhjet e tij në vend konflikti dhe bllokimesh nga të dyja palët. Në këtë raport monitorues mjaft vendime të bashkisë Vlorë janë kthyer nga ana e Këshillit Bashkiak për saktësime ose sqarime të mëtejshme, ndërsa edhe nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë ka patur situata bllokuese, ku institucioni e cilësoi të paligjshëm projekt-buxhetin e vitit 2022, miratuar në Këshillin Bashkiak me dhjetor të 2021, ku mund të përmendim mos miratimin e buxhetit vjetor brenda afatit që parashikon ligji, ndërsa miratimi i tij është bërë në mënyrë unanime më 31 janar të 2022, me vendim nr.4 nga KB i Vlorës.

Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Vlorë vazhdojnë të jenë të tensionuara, në çdo mbledhje kërkohen sqarime për çështje të ndryshme, në mjaft raste kërkesat e anëtarëve të KB nuk kanë marrë përgjigje, ndërsa mjaft vendime të rëndësishme të propozuara nga bashkia Vlorë nuk janë miratuar ose janë shtyrë afatet e vendimarrjes nga ana e këshillit.

Kjo marrëdhënie bllokuese midis dy institucioneve ka sjellë shërbime të munguara drejt qytetarëve, ndërsa rekomandohet që Bashkia Vlorë dhe KB Vlorë duhet të luajnë rolin që qytetarët i kanë mandatuar, duke qenë më pranë komunitetit dhe duke mbështetur shqetësimet e tyre në vendimarrje gjithëpërfshirëse dhe jo të njëanshme.

## Vlerësimi i qytetarëve

Pjesëmarrja qytetare është një komponent mjaft i rëndësishëm në monitorimin e Kontratës Sociale. Mendimet dhe opinionet e tyre janë një njësi analize që masin dhe vlerësojnë situatën konkrete në territor. Mendimi qytetar është tërhequr përmes takimeve, fokus-grupeve, vlerësimeve online dhe gjatë dëgjesave me publikun për procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje. Qytetarët kanë sjellë shqetësimet kryesore mbi prioritetet që mbeten ende për tu adresuar dhe për tu buxhetuar nga ana Bashkisë Vlorë, gjithashtu kanë ngritur edhe çështje të reja ku duhen ndërhyrje konkrete nga vendimarrësit.

Projekti ka hyrë në vitin e tretë të realizimit të tij dhe metodologjia përmes të cilës ai realizohet është interaktive, duke lejuar modifikime të nevojshme për të prekur rezultate konkrete. Ndërsa takimet me qytetarët vazhdojnë të realizohen dhe kërkesat e tyre të përkthyer në prioritetet që kërkojnë zgjidhje vazhdojnë të shtohen, Qendra Rinore e Vlorës ka kërkuar që të orientojë punën e saj drejt grupeve që aktivizohen, por edhe gjejnë mënyra që të jenë dinamike në përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Ndërsa Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak vazhdojnë të miratojnë pafund dokumente, udhëzues dhe polemika, gjatë monitorimit të realizuar është vënë re që besimi dhe përfaqësimi i qytetarëve në vendimarrje është në nivelet më të ulta.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk kanë ende platforma apo mekanizma që raportojnë për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, ndërsa janë limituar ndjeshëm dhe kanalet e komunikimit ballë për ballë ose online me qytetarët.

Monitorimi i vendimarrjes së Këshillit Bashkiak, ka qënë një burim i mirë informacioni për Qendrën Rinore të Vlorës, ku nga analizimi i dokumentave kemi marrë informacion të detajuar për Kontratën Sociale, ndërkohë që në takimet që kemi realizuar me qytetarët, të rinjtë, grupe interesi dhe gazetarë, kemi shpërndarë sa më shumë informacion rreth çështjeve me prioritet.

Publiku është mbajtur i informuar përmes postimeve në rrjetet sociale, publikimit dhe raportimit në mediat lokale.

Ndarja e raportit të dytë të monitorimit, na ka vënë përballë shqetësimeve të komunitetit që presin të adresohen. **Dy** takime janë zhvilluar me të intersuar lokalë, anëtarë të KB dhe staf Bashkisë Vlorë në muajt shkurt, mars 2022, me një pjesëmarrje prej **44 personash (21F/23M)**.

Janë trajnuar **29 të rinj (19F/10M)**, aktivistë të organizatës mbi mjetet dhe teknikat e verifikimit të fakteve, dhe pas ngritjes së kapaciteteve ata kanë prodhuar dy materiale informues mbi prioritetin nr.6 për funksionimin e vendepozitimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë, mbi premtimin e pa realizuar të saj si dhe prioritetin nr. 1, shtrimin e rrugës së fshatit Kërkovë.

Në **prill 2022**, në Orikum u mbajt një takim me **9** anëtare gra të këtij komuniteti. Së bashku me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në Vlorë dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishim në Orikum në një takim ku u mbledhën shqetësimet e anëtarëve të komunitetit. Gjatë takimit u diskutua mbi nevojat e qytetarëve dhe prioritetet e Kontratës Sociale. Qytetarët u mbështetën duke adresuar disa prej shqetësimeve të tyre përmes kërkesave dhe ankesave kundrejt bashkisë Vlorë për çështje si mbledhja e mbeturinave dhe largimi i tyre nga vend-depozitimi aktual, ndalimi i djegies së mbeturinave, rritja e cilësisë së pastrimit nga kompania e kontraktuar për ofrimin e këtij shërbimi, përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, infrastruktura rrugore dhe çështje në lidhje me pronësinë e tokave.

Në muajin **maj 2022**, në stendën e Sudisë, në kuadër të Javës Evropiane, organizuar nga Delegacioni Evropian në Shqipëri, patëm mundësinë që të shkëmbejmë me mbi **60 qytetarë** dhe grupet e interesit arritjet dhe sfidat në përmbushjen e Kontratës Sociale.

Ndërsa një pjesë e mirë e prioritetëve, janë artikuluar edhe në takimet e **Buxhetimit me Pjesëmarrje** në periudhën **shtator 2022**, si prioritetet që kanë nevojë të adresohen me mbështetje financiare në buxhetin vendor, ku Qendra Rinore e Vlorës ka asistuar **9 dëgjesa publike**, nga ku u mbledhën mbi **60 prioritetet** dhe morën pjesë **219 persona (62 F/157M)**.

Në muajin tetor 2022 u realizuan **dy fokus-grupe** për informimin e komunitetit mbi përmbushjen e prioritetëve të Kontratës Sociale, në Vlorë dhe Novoselë. Në to morën pjesë **29** anëtarë të komunitetit (**23F/6M**) ku u diskutuan gjetjet rreth monitorimit të prioritetëve të kontratës sociale si dhe u vlerësuan prioritetet që presin ende të adresohen. Qytetarët ishin të vetëdijshëm që shumë prej prioritetëve kërkojnë investime madhore të Bashkisë Vlorë, ndërsa FSHZH mbetet një prej investuesve më të mëdhenj për investimet në qytet dhe Nj.A. Gjithsesi pjesëmarrësit diskutuan për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, përmes vlerësimeve që dhanë për çdo prioritet, pjesë e vlerësimit të mëposhtëm.

Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkisë, është shpërndarë një pyetësor online, nëpërmjet të cilit të gjithë qytetarëve u është dhënë mundësia të shprehin preferencat e tyre për buxhetin e bashkisë. Të dhënat e mbledhura online, janë përpunuar dhe analizuar duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. **642 qytetarë (300F/342M)** janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, pjesë e këtij raporti për vlerësimin e qytetarëve.

**Tre plane advokimi** për prioritetet e Kontratës Sociale u përgatitën dhe u realizuan përgjatë periudhës shtator 2021 – shtator 2022. Si përfundim tre peticione janë firmosur dhe i janë dërguar bashkisë dhe KB Vlorë për ndërhyrje që janë: **1.** Shtrimi i rrugës së Kishës së Marmiroit – Nj. A Orikum dhe **2.** Investime në rrugën lidhëse midis fshatit Kërkovë dhe Bestrovë, që janë dërguar Komisionit të Ankesave, Kërkesave dhe Peticioneve të KB Vlorë gjatë vitit 2021. Rreth **36 qytetarë (23M/13F)** kanë nënshkruar të dy peticionet. Ndërsa fushata advokuese **për**

**transportin publik** ka mbledhur firmat e **56** anëtarëve të komunitetit (**36F/ 20M**) për të ndërhyrë në veprime konkrete në buxhetin vendor për adresimin e këtij prioriteti, në muajin shtator 2022.

***Më poshtë po listojmë gjetjet nga takimet me qytetarët për çdo prioritet të Kontratës Sociale.***

**Prioriteti 1:** - Investimet e realizuara që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e banimit, të identifikuar nga qytetarët për ndërhyrje janë përmirësuar me investime konkrete dhe nga **50%** e prioritetëve në raportin e parë të monitorimit në **70%** e investimeve në qytet, ndërsa për vitin e tretë të monitorimit ky progres vlerësohet në masën **78%** nga qytetarët, të cilët nuk e vlerësojnë pozitivisht progresin për këtë periudhë, për shkak se projekti i shtrimit të linjave të brendshme të ujësjellësit gjatë fillimit të vitit 2022, ka dëmtuar gjithë rrugët në gjëndje të mirë dhe ende nuk është kthyer infrastruktura rrugore në gjëndjen ekzistuese. Ndërsa shumë pak investime ka patur nga bashkia për këtë prioritet. Në takimet e realizuara, qytetarët shprehen se ka ende shumë punë për tu bërë, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Ata kanë identifikuar nevojat për: Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe ndriçimin në lagjet “Pavarësia” dhe “Hajro Çakërrri”; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në lagjen “Kushtrimi”; Rikonstruksioni i rrugës “Prenjo Petoshati”, Lagjia “24 Maji”; Ndërhyrje në infrastrukturë në lagjen “10 Korriku”, rruga “Daut Metushi”; Përmirësimi i infrastrukturës në lagjen “1 Maj” tek rruga në periferi të lagjes ku mungon infrastruktura rrugore; Investim në infrastruktura rrugore në lagjen “11 Janari”; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në rrugën “Shtjefen Gjeçovi”; Lagja “10 Korriku”, Rruga “Donika Kastrioti” me probleme të theksuara ka nevojë për investim në infrastrukturën rrugore dhe ndriçim; Shtrimi i trotuareve në zonën e Kuzum Babasë, pasi banorët, rrezikojnë jetën duke ecur në korsinë e makinave; Riparimi i rrugës pranë shkollës “Lef Sallata” e cila përmbytet në sezonin reshjeve dhe vështirëson kalimin a nxënësve; Rikonstruksioni i trotuarit tek rruga “Misto Mele” dhe ndërhyrje në sistemin e ndriçimit; Shtrimi i rrugës mes bllokut të ri përballë ish-shtepisë së oficerave; Rikonstruksioni i rrugës “Kostandin Kristoforidhi” të Kisha Katolike; Rikonstruksioni i rrugës “Jani Gjoncari” pas monumentit të Pavarësisë; Ndërhyrje në infrastrukturë në lagjen “28 nëntori”, (blloku i banimit pas kopshit nr. 10, nga pjesa e pasme e pallatit të L-ja deri tek rruga “Pilo Begaj”); Rikonstruksioni i rrugës “Dhimitër Konomi”, ose siç njihet me termin unaza e re, pas dëmtimit nga projekti i ujësjellësit; Ndërhyrje në rrugën përballë shkollës “Ismail Qemali” Lagjia “Isa Boletini”; Shtrimi i rrugës “Shaban Demiraj”

Në Njësitë Administrative shumë rrugë mbeten për tu rregulluar, gjithsesi qytetarët kanë identifikuar dhe vlerësuar pozitivisht ato pak ndërhyrje që bashkia realizoi në periudhën zgjedhore, ndërsa për këtë vit të monitorimit raportohet se ka shumë pak ose aspak ndërhyrje në prioritetet e Kontratës Sociale.

Në **Orikum:** Ndërhyrje në rrugët e brendshme dhe blloqet e banimit në Orikum, rruga buzë detit është bërë vetëm nga njëra anë, duhet bërë ana tjetër deri tek postblloku i vjetër. Në **NJA Qendër** Kërkohej ndërhyrje në rrugët e Bestrovës dhe Panajasë dhe në rrugët e brendshme.

**Shushicë:** Rikontruksioni i rrugëve lidhëse Risili-Çeprat-Bunavi. Në **Nj.A Novoselë** ka filluar përmirësimi i infrastrukturës në rrugën e vjetër që lidh Vlorën me Fierin, duke u përshëndetur nga qytetarët si një mundësi që përmirëson aksesin e tyre në qytet. Ndërsa kërkohen ende përmirësimi i rrugëve lidhëse ose të brendshme të fshatrave Mifol, Aliban, Fitore, Delisuf, Poro Cerkovinë dhe Trevllazër. Ndërkohë vazhdojnë të mbeten prioritet për ndërhyrje rrugët e varrezave të fshatrave, Cerkovinë, Trevllazër dhe Mifol.

**Prioriteti 2:** - Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm në qytet dhe zgjatja e orarit të furnizimit me ujë në të gjithë qytetin Në qytetin e **Vlorës**. Qytetarët shprehen se janë të pakënaqur me aksesin që kanë për tu furnizuar me ujë të pijshëm, edhe pse janë bërë pjesë e investimeve madhore në këtë sektor nga qeverisja qendrore. Ata kërkojnë përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm në lagjet “Hajro Çakëri”, “Kushtrim” dhe “10 Korriku; Zgjidhja e problemit të mungesës së ujit të pijshëm në lagjen “Lirim”. Kërkohet ndërhyrje cilësore dhe përfundim i rrjetit të ujësjellësit në zonën e Ujit të Ftohtë-Lungomare – Rrapi Ujë i ftohtë – Shkolla e Marinës; përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat periferike të Vlorës (zona Transballkanike). **Novoselë:** Kërkohet të planifikohet ndryshimi i projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të 15 fshatrave në Nj.a Novoselë duke kërkuar përfshirjen e rrjetit të brendshëm nga Alibani deri në Akërnë dhe në Kërkovë. **Orikum:** Zgjatja e orarit të furnizimit me ujë të pijshëm në Orikum. **Qendër:** Zëvendësim rrjeti dhe përmirësim të shërbimit të shpërndarjes së ujit të pijshëm në Kaninë, Sherishtë, Zvërnec, Nartë. Në **Nj.A Shushicë:** Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë dhe cilësisë së ujit. Depoja e ujit në Drithas nuk e përballon furnizimin me ujë, ka nevojë të gjendet një zgjidhje.

**Prioriteti 3:** - Përmirësimi i cilësisë së kanalizimeve, vazhdon të mbetet një sfidë për Nj.A ku pothuajse nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve, ndërsa në **Vlorë** në disa zona të veçanta të saj, është përmirësuar sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza. Gjithsesi banorët kërkojnë pastrimin e kanaleve në disa lagje të qytetit dhe kanalizimeve për të parandaluar përmblytjet në kohën e reshjeve. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike të qytetit. Pastrimi i kanalit në lagjen “Kushtrimi”; Ndërhyrje në kanalizimet e ujërave të zeza në lagjen “Kushtrimi”; Riparimi i çarjeve të tubave të ujit/kanalizimeve në lagjen “Hajro Çakëri” rruga “Xhemil Bej Vlora”, zona e Kuzum Babasë të cilat rrezikojnë muret e banesave; Ndërhyrje në infrastrukturë pellgjet sezonale të ujit që krijohen në rrugën Ali Demi apo sic quhet ndryshe dhe rruga e spitalit; Pastrimi i kanalit të Fusha e Aviacionit; Në **Novoselë:** Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, sidomos në fshatrat Mifol dhe Akërnë, si dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Panaja. Gjithsesi gjithë Nj.A-të nuk kanë rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza. Në **Orikum:** Kullimi i pjesës së kënetës që është bërë vatër infeksioni duke krijuar shqetësim për banorët e zonës dhe turistët gjatë verës. Pastrimi i kanaleve kullues dhe ndërhyrje për sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza që vazhdojnë të derdhen në det. Në Nj.A **Qendër Vlorë:** Rikonstruksioni i rrjetit të ujërave të ndotura në fshatrat Bestrovë, Kërkovë, Panaja, Oshtimë, Sherishtë, Babicë, Kaninë, Zvërnec, Nartë. Ndërsa në **Nj.A Shushicë:** Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura. Kërkohet zgjidhja e problemit të përmblytjeve në Risili.



**Prioriteti 5:-** Në lidhje me **transportin publik**, nevojitet përmirësim dhe shtim i linjave të reja jo vetëm në zonat periferike të qytetit, por edhe në Nj.A. Ndërsa periudha e verës vuri në vështirësi serioze shërbimin e transportit, kryesisht gratë dhe operatorët turistikë kërkojnë afishim të orareve dhe linja të shtuara të shërbimit në zonën turistike dhe në fshatra të Vlorës. Transporti midis Nj.A- ve dhe Vlorës është zgjidhur përmes linjave private të furgonave privatë. Ndërsa qytetarët kërkojnë afishim të orareve të transportit publik dhe zgjatje të orarit, sidomos gjatë verës për personat në punë sezonale me orare të vona. Ky prioritet ka nevojë të adresohet për zgjidhje nga ana e bashkisë Vlorë.

**Prioriteti 6:-** Edhe pse në bashkinë e Vlorës ishte premtuar se punimet për fazën e parë të ndërtimit të **venddepozitimit të mbetjeve urbane** në zonën e Sherishtës do të mbaronin në muajin **mars të 2022**, qytetarët e sidomos përfaqësues të shoqërisë civile shprehen se ende nuk kanë informacion mbi përfundimin e kësaj veprë madhore që nuk është bërë ende funksionale për të ofruar shërbimin e grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave për bashkitë e Vlorës dhe Selenicës. Gjithsesi ata shprehen se kanë ardhur makineri të reja dhe koshat janë shpërndarë në të gjithë territorin e bashkisë Vlorë. Një artikull me fakte për këtë çështje është prodhuar nga të rinjtë, pjesë e fushatave të advokimit për prioritetet e Kontratës Sociale.

**Ndërkohë për prioritetin 7**, atë të përmirësimit të **pastrimit të qytetit dhe Nj.A**, qytetarët raportojnë se gjatë verës së 2022, ka patur probleme në qytet përse i takon mbledhjes së mbeturinave, ndërsa janë informuar përmes mediave për procese gjyqësore midis bashkisë dhe firmës private që kryen pastrimin. Në muajin gusht ata referojnë se ka patur përmirësim të situatës ku kanë verifikuar se edhe bashkia Vlorë dhe firma e pastrimit kanë kryer të njëjtin shërbim. Ndërsa në Nj.A të Vlorës firmat e pastrimit kryejnë rregullisht procesin, duke sjellë ndryshim në rrugët kryesore të fshatrave që së fundmi janë paisur edhe me kosha. Ata rekomandojnë se gjatë verës zona bregdetare ka nevojë për intensifikim të pastrimit të rrugëve kryesore në zonën bregdetare.

**Prioriteti 8:-** Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve prej shtatorit të 2021 e deri në shtator të 2022, është një shërbim që është vlerësuar pozitivisht nga qytetarët. Ata raportojnë se janë realizuar takime të hapura për të aplikuar në skemat mbështetëse dhe se janë asistuar nga nën/kryetarja e bashkisë dhe agronomët e Nj.A-ve për të marrë informacione dhe shërbime për të rritur prodhimin në fermat ose bizneset bujqësore të njëjseve. Procesi i menaxhimit të tokave, vazhdon të realizohet me ritme të ulta, ndërsa nevojitet më tepër mbështetje për këtë prioritet të rëndësishëm.

**Prioriteti 9:** Qytetarët shprehen se bashkia e Vlorës i informon dhe mbledh taksat rregullisht, ndërsa kërkojnë më tepër shërbime për taksat që paguajnë, kryesisht në sportelet e ujësjellësit apo drejtorive të tjera të këtij institucioni. Në zonat rurale të Vlorës, kërkohet që të vazhdojë të aplikohet diferencim i taksave dhe tarifave. Sektori i biznesit është ankuar që në janar të 2022, është bërë efektiv aplikimi i rritjes së taksave/tarifave vendore, kryesisht tarifa e pastrimit, ndërsa procesi ka kaluar pa konsultimin e tyre gjatë procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

**Prioriteti 10:-** Edhe pse punësimi i grave dhe të rinjve mbetet një prioritet në Vlorë, qytetarët raportojnë se kanë pak ose shumë pak akses në mundësitë e punësimit. Turizmi vazhdon të jetë prioritet ndërsa largimi i qytetarëve jashtë Shqipërisë, vendosi para sfidave sektorin e biznesit kryesisht atë turistik në verën e vitit 2022, për të gjetur punëtorë të kualifikuar në këtë sektor. Roli i bashkisë ose KB për të mbështetur këtë sektor, sipas këndvështrimit qytetar është i parëndësishëm, duke mos kryer asnjë proces ndërmjetësimi apo formimi profesional për të rritur punësimin e banorëve të tyre. Ndërsa punësimi në sektorin privat rregullohet kryesisht në mënyrë të pavarur nga tregu i kërkesës dhe ofertës, bashkia mund të ndërtojë ose të lehtësojë infrastrukturën, transportin apo edhe incentiva të tjera, që mbështesin punësimin e grave dhe të rinjve duke fuqizuar në këtë mënyrë dhe ekonominë lokale.

**Prioriteti 11:-** Buxhetimi me Pjesëmarrje është një praktikë pozitive e realizuar prej disa viteve në bashkinë Vlorë, ndërkohë që qytetarët shprehen se kanë pak informacion rreth takimeve publike, ndërsa dhe ata pjesëmarrës që janë pjesë në dëgjesat publike raportojnë se prej vitesh vazhdojnë të artikulojnë kërkesat e tyre dhe ato nuk merren parasysh nga ana e stafit të bashkisë. Qytetarët raportojnë se në periudha parazgjedhore, bashkia ka mundësi më shumë të realizojë kërkesa për komunitetin e tyre, ndërsa rekomandojnë që procesi të jetë me rezultate konkrete, jo vetëm në takime informuese ku mbledhen nevojat e tyre, por të jenë dhe mundësi ku qytetarët mund të mbështeten me financime konkrete për prioritetet e tyre.

**Prioriteti 12:-** Bashkia e Vlorës në muajin gusht 2022, përmes një thirrje të hapur në mediat sociale dhe faqen e saj të internetit ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë. Gjithsesi nevojiten ende përpjekje që kjo strukturë të jetë aktive dhe të përfaqësojë të rinjtë në vendimarrje.

## Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që Qendra Rinore e Vlorës i ka dërguar bashkisë Vlorë, takimeve me staf të bashkisë, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave si dhe në informacionet e mbledhura nga të dhënat e hapura (shpenzime dhe prokurime) të qeverisjes vendore si dhe nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Vlorë. Gjithashtu janë analizuar dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak i Vlorës për periudhën shtator 2021 – shtator 2022.

Progresi i realizimit të prioritetëve raportohet në disa faza që janë:

**Prioritet i pa realizuar**

**Prioritet i adresuar pjesërisht** (Prioritet i buxhetuar ose prioritet i prokuruar)

**Prioritet i realizuar**

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se bashkia Vlorë ka adresuar prioritet si më poshtë:

## PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

- Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit.

**Për rajonet e qytetit Vlorë.** I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosi e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.

### Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:

Gjetjet nga raporti i dytë i monitorimit treguan se nga 10 indikatorë ishin përfunduar me investime konkrete 7 të tillë, që vlerësonte progresin në masën 70%. Gjatë monitorimit të periudhës së tretë shtator 2021 - shtator 2022, janë realizuar ndërhyrje të vogla dhe progresi vlerësohet i ulët krahasuar një vit më parë.

Prioritete të realizuara	Prioritete të parealizuara
Zona tek Fusha e Drurit	Lagjia pas kopshtit Nr 10
Rruga tek Tregu i Madh	Rruga “Jani Kosta/Rexha”
Rruga pas KSHA-së	Rruga tek fusha e aviacionit
Rruga nga fabrika e tullave	
Porti drejt plazhit të vjeter	
Rruga dhe lagjia pas Stadiumit (Mato Robi)	
Vendosi e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon. (i realizuar pjesërisht)	

Më poshtë japim informacion rreth progresit të tre indikatorëve që kanë mbetur pa realizuar në listën e rrugëve të përfshira në Kontratën Sociale për Vlorën.

**Lagjia pas kopshtit Nr 10** – Prioritet i adresuar pjesërisht, gatë diskutimit të prioriteteve të Kontratës Sociale me staf të Bashkisë u theksua se është përgatitur projekti për rikonstruksionin e kësaj lagje dhe po punohet për të gjetur financim. Ky prioritet ende nuk është realizuar.

**Rruga te fusha e aviacionit:** Një premtim i dhënë banorëve në periudhat zgjedhore, nuk ka gjetur ende zbatim me fonde. Nga ana e bashkisë Vlorë theksohet se fondet që ajo ka në dispozicion janë modeste dhe për këtë ndërhyrje do të duhej mbështetja e FSHZH-së, gjithsesi sipas referimeve të Bashkisë, do të jetë pjesë e rikualifikimit pasi të largohet venddepozitimi i mbetjeve urbane, ndërsa vazhdon të mbetet një prioritet i pa realizuar. Kemi mbledhur informacion, që në muajin tetor kjo zonë do jetë pjesë e ndërhyrjes nga FSHZH-së, në kuadër të përmirësimit të mobilitetit në zonën e ish fushës së aviacionit, por ende nuk kemi gjetur

dokumente mbështetëse për këtë ndërhyrje. Deri në periudhën e raportimit theksojmë se ky prioritet ende nuk është realizuar.

Rruga Jani Kosta/Rexha është bërë pjesë e rikualifikimit të bllokut të banesave kufizuar nga Bulevardi "Çameria", Rruga "Pelivan Leskaj", Rruga "Kujtim Beqiri", Rruga "Piro Sava" me fondin prej 4,442,884 lekë. Ky prioritet është adresuar pjesërisht (përgatitje e projektit dhe hapje e procedurave të tenderimit)

Në lidhje me vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku mungon, nga bashkia konfirmohet se sektori i shërbimeve dhe rrugë-trotuareve ka ndërhyrë pjesërisht në vendet ku janë dëmtuar trotuaret dhe kanë vendosur sinjalistikën vertikale përmes tabelave. Gjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i miëmbajtes së rrugëve, trotuareve dhe plazheve publike janë bërë vizimet e këmbësorëve përgjatë Lungomares, vizimet e korsive të biçikletave, të këmbësorëve në bulevardin Vlorë-Skelë dhe në unazën paralel me Lungomaren. Prioritet i adresuar pjesërisht.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 50% në vitin e parë të monitorimit në 70%+ në vitin e dytë të monitorimit, në 80 % për vitin e tretë të monitorimit periudha shtator 2021-shtator 2022 (nga 10 indikatorë janë përfunduar 7). Prioritet i adresuar pjesërisht.**

**Novoselë.** Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë.

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Gjatë vitit 2021 – 2022, janë mbyllur punimet dhe pagesat për projektin, "Rehabilitimit dhe Riasfaltimit të Rrugëve Cerkovinë - Skrofotinë – Trevllazër", duke përfunduar një prej prioritetëve të Kontratës Sociale. **Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.**

Gjithashtu me fonde të FSHZH-së, rruga e vjetër që lidh Vlorën me Fierin i është nënshtruar rikualifikimit dukë rritur aksesin e fshatrave të Nj.A Novoselë drejt qytetit. Rregullimi i këtij segmenti do të rrisë mobilitetin dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Mbetet që në të ardhmen bashkia e Vlorës të punojë seriozisht për rregullimin e rrugëve lidhëse midis fshatrave dhe rrugës kryesore ku aktualisht po punohet. Gjithashtu dhe ndërtimi i Aeroportit të Vlorës që ndodhet në këtë Nj.A pritet ti sjellë zhvillim zonës së sipërpërmendur. Pas riasfaltimit të rrugëve lidhëse midis fshatrave kryesore, kërkohet nga qytetarët që të vazhdojnë investimet edhe në fshatrat e tjerë të Nj.A Novoselë.

**Orikum.** I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Rradhimës dhe të Thilpetit.

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Nga lista e indikatorëve për ndërhyrje në Nj.A Oriku, sistemimi i rrugës së *Kishës së Marmiroit* edhe pse është listuar në projekte që kanë nevojë të financohen në buxhetin e vitit 2022 dhe është përgatitur projekti nga drejtorja e Urbanistikës me buxhetin përkatës, vazhdon në mbetet në listën e projekteve që kërkojnë financim me mbështetje nga FSHZH. Edhe pse u përgatit një peticion me banorë të kësaj zone, nga bashkia vazhdon të jepet e njëjta përgjigje, që fondet që ajo ka në dispozicion për këtë njësi, nuk mund të mundësojnë realizimin e këtij projekti. Gjatë vitit 2022, në Oriku, bashkia ka kryer vetëm rehabilitimin e rrugës Demokracia, drejt rrugës “Gjergj Kastrioti”.

*Rruga buzë detit* është bërë pjesërisht, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, vetëm njëra anë ndërsa duhet përfunduar edhe segmenti tjetër deri tek postblloku i vjetër. Ndërsa rruga lidhëse e Tragjasit është përfunduar, por nevojitet edhe zgjerimi i rrugës së Radhimës. Pastrimi i i kanaleve në Tragjas, Dukat dhe Radhimë është një proces që realizohet, por qytetarët nuk raportojnë ndonjë ndryshim të situatës.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 10% në 30% për periudhën e dytë të monitorimit, vlerësohet se nuk ka progres dhe vazhdon të jetë për vitin e tretë të monitorimit me 30% dhe është prioritet i parealizuar.**

**Qendër Vlorë.** Kërkohet ndërhyrje urgjente në rrugët lidhëse të *Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.*

**Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Është realizuar rikonstruksioni i rrugës *Panaja – Hoshtimë*. Punimet janë realizuar nga Avduli shpk dhe gjatë vitit 2022 janë kryer dhe pagesat nga bashkia Vlorë. Aktualisht është rezultat i përfunduar.

Rruga *Babicë e Vogël - Xhyherinë* është realizuar gjatë 2021 dhe likuaduar në të njëjtin vit nga stafi i bashkisë.

Rruga e Sherishtës e përfshirë në projektin “Rikualifikim urban në Njësinë Administrative Qendër (Nartë + Sherishtë)”, ka përfunduar.

*Rruga lidhëse midis Kërkovës dhe Bestrovës.* Në periudhën tetor-nëntor 2021, përmes një peticioni të mbështetur nga Qendra Rinore e Vlorës dhe kërkesave të artikuluara në procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje, banorët e fshatit Kërkovë kërkuar vendosjen në buxhetin e vitit 2022 të rikonstruksionit të rrugës së fshatit Kërkovë. Në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Vlorë, kjo kërkesë e qytetarëve u përfshi në buxhetin vendor, përmes hartimit të projektit dhe alokimit të fondeve në buxhetin e vitit 2022, me një vlerë totale prej 30 830 000 lekë e parashikuar të ndahen në dy vite financiare, atë të 2022 dhe 2023. Në muajin korrik është shpallur tenderi nga ana e Bashkisë Vlorë dhe nga komunikimet me bashkinë, jemi informuar se tenderi është mbajtur në muajin gusht të 2022, ku kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomikë. Ne vlerësojmë përpjekjet e banorëve të këtij fshati, që së bashku me Qendrën Rinore të Vlorës,

koordinuan veprimet, ku përmes peticionit dhe fushatës së advokimit, rikonstruksioni i rrugës do të jetë një prioritet i kthyer në një investim konkret. Aktualisht raportojmë se ky prioritet është plotësuar në masën **70%**.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 70% në vitin e dytë të monitorimit në 90% në vitin e tretë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar plotësisht (Prioritete të buxhetuar, të prokuruar dhe të realizuar).**

**Shushicë.** Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Nga raporti i dytë i monitorimit është përfunduar rikonstruksion i rrugës lidhëse Shushicë-Beshisht. Gjithashtu edhe rruga e varrezave në fshatin Drithas është rikonstruktuar.

Bashkia Vlorë ka përgatitur dhe dokumentacionin përkatës gjatë 2022, për të tenderuar edhe rrugët e mëposhtme: Rehabilitimi i rrugës së fshatit Drithas dhe rehabilitim i rrugës së fshatit Grabian në Nj.A Shushicë.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90% nga 80%+ periudhën e dytë të monitorimit në dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i prokuruar dhe i realizuar)**

### **PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM**

- Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë:

*Për rajonet e qytetit Vlorë. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm.*

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Nga informacionet e grumbulluara në vitin e dytë të monitorimit, Bashkia e Vlorës me fondet e saj dhe kryesisht ato të Buxhetit të Shtetit në Vlorë janë duke realizuar disa projekte madhore në çështjen e rëndësishme, atë të përmirësimit të furnizimit me ujë. Më poshtë listojmë ndërhyrjet në këtë sektor të cilat vazhdojnë prej 2020 e deri më sot, ndërsa parashikohet që përfundimi i tyre të jetë në 2023-2024: Në total vlera e këtyre investimeve nga buxheti i shtetit vlerësohet të jetë për vitin 2023 në vlerën 190 milion lekë të reja, nga të cilat bashkia Vlorë bashkëfinancon 17% të kësaj vlere.

- Përmirësime të sistemit të furnizimit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të Vogël, Nj.A Qendër Vlorë, vazhdim nga 2021;
- Ndërtim KUZ, rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë, vazhdim nga 2021;
- Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë, në vazhdim nga 2021;

- Ujësjetllësi -Zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungomares Rrapi Uji i Ftohtë - Shkolla e Marinës, vazhdim;
- Ndërtimi i ujësjetllësit në rrugën transballkanike Vlorë, Bashkia Vlorë, vazhdim nga 2021
- Rikonstruksion i ujësjetllësit në 15 fshatrat e njësisë Administrative Novoselë, vazhdim nga 2021;

Aktualisht edhe në vitin e tretë të monitorimit, furnizimi me ujë të pijshëm bëhet dy herë në ditë, në gjithë qytetin e Vlorës, me përjashtim të zonës së Ujit të Ftohtë, që furnizohet me ujë 24 orë në ditë. Ndërsa gjithë Nj.A-të vazhdojnë të furnizohen me ujë në orare të caktuara, ndërsa shumë prej tyre vuajnë nga cilësia jo e mirë e ujit. Edhe pse projektet në sektorin e ujësjetllësit janë ende në fazën e zbatimit, komuniteti ka paraqitur shqetësimet për mënyrën si po realizohen kryesisht duke raportuar a)për dëmtimet në infrastrukturën rrugore, b) kërkesa për ndryshim të projekteve fillestare që kanë ardhur nga Nj.A-të. Mbetet për tu verifikuar nëse cilësia e punimeve do jetë në funksion të realizimit të qëllimit final, atë të aksesit dhe furnizimit me ujë të banorëve të Bashkisë Vlorë. Të gjitha këto projekte synojnë ndërhyrje afatëgjata që do të përmirësojnë ndjeshëm situatën.

Në lidhje me sigurinë dhe pastërtinë e ujit qytetin e Vlorës çdo ditë monitorohet cilësia e ujit të pijshëm, nga Njësia e Shëndetit Publik. Kontrolli bëhet në 22 pika ku ekzaminohen parametrat kryesorë të ujit të pijshëm, përmbajtja e përqindjes së klorit rezidual në ujë dhe ngarkesa bakteriale MPN. Përcaktohet cilësia dhe siguria për konsum të ujit. Gjithësesi në qytet pjesa më e madhe e banorëve nuk e konsumojnë ujin e rubinetit si ujë të pijshëm. Edhe në linjat e furnizimit me ujë në 24 orë, gjatë verës ka patur avari të shumta duke e bërë ujin të pa konsumueshëm.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ për vitin e tretë të monitorimit nga 70%+ në vitin e dytë dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritete të prokuruarra dhe duke u realizuar).**

**Novoselë.** Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin veçanërisht gjatë verës.

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Mbetjeve (AKUM), me fondet e buxhetit të shtetit dhe Bashkia Vlorë janë duke vazhduar investimin në projektin e rikonstruksionit të ujësjetllësit të 15 fshatrave të Nj.A Novoselë. Në projektin e ri punimet përfshijnë zëvendësimin e pompave ekzistuese për 7 puset më të reja dhe të tubove të vjetra të dërgimit në rezervuarin grumbullues qendror; zëvendësimin e linjave të ujësjetllësit për 15 fshatrat; përmirësimin e rrjetit shpërndarës për lagjet e reja dhe do të instalohen rreth 4,180 matës të ujit për të gjithë fshatrat e zonës të Novoselës.

Gjithësesi gjatë komunikimeve të anëtarëve të KB me përfaqësues nga Nj.A Novoselë projekti që aktualisht po zbatohet ka nevojë për rishikime dhe ndryshime të reja. Kërkohe të planifikohet ndryshimi i projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të 15 fshatrave në Nj.a

Novoselë duke kërkuar përfshirjen e rrjetit të brendshëm nga Alibani deri në Akëri dhe në Kërkovë. Projekti për një periudhë kohe është pezulluar, ndërsa firmat zbatuese B.O.E, “GENER 2” & “Rroku GUEST” shpk mbeten në pritje të pagesave për të vazhduar realizimin e kontratës. Ndërsa përfundimi i punimeve është parashikuar 2024.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80% nga 60%+ në raportin e periudhës së dytë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshtetje financiare nga AKUM dhe tenderim e lidhje kontrate dhe likuidim të punimeve nga bashkia)**

***Orikum.** Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.*

**Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Projekti i furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat Dukat-Tragjas-Jonufër-Radhimë, financiar nga FSHZH dhe bashkëfinancim nga bashkia Vlorë, për paisjen me furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, është në fazën e finalizimit. Nuk kemi të dhëna nëse bashkia Vlorë e ka marrë në dorëzim këtë vepër, por ende dhe sot zona e Nj.A Oriku vazhdon të vuajë mungesën e ujit, që në qytet vjen dy orë në ditë nga 45 minuta. Ndërsa ‘Ujësjetës Kanalizime Vlorë sh.a’ vazhdon të kërkojë financime për qytetin e Oriku. Gjatë vitit 2022, me fonde të FSHZH në vlerën 6,9 milion euro është parashikuar ndërtimi/rikonstrukcioni i Rrjetit të Ujësjetës Kanalizimeve Oriku, Impianti i Trajtitit të Ujërave të Zeza. Procedurat e tenderimit dhe lidhja e kontratës me subjektin Alkelik Group, kanë përfunduar në muajin maj të 2022, ndërsa periudha e zbatimit do të jetë 19 muaj e ndjekur nga një periudhë 12 mujore e njoftimit të defekteve.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 95%+ dhe është prioritet i adresuar drejt përfundimit.**

***Qendër Vlorë.** Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.*

**Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Situata për banorët e fshatrave që presin prej vitesh të furnizohen me ujë është e njëjtë, pa ndryshime konkrete gjatë raportit të tretë të monitorimit. Një zgjidhje provizore është ofruar nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë, duke montuar një pompë të re në Shushicë dhe shtrimin e linjave të reja në Babicë. Ndërsa gjatë vitit të tretë të monitorimit ka vazhduar të kryehen pagesa përgjatë 2022 për programin e “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjetës në Babicë të Vogël, Njësia administrative Qendër Vlorë” gjatë vitit 2023, parashikohen të tjera fonde në buxhetin e afatmesëm. Gjithësesi ndërhyrjet kanë qënë provizore dhe nuk ka të dhëna për ndryshimin e situatës.



Gjatë periudhës së raportimit është projektuar një stacion i përbashkët shtytës (pompa) për depot e fshatrave si: Kërkovë, Panaja, Oshëtimë dhe Bestrovë. Aktualisht është dhënë një zgjidhje provizore, për furnizimin me ujë në një linjë kryesore, ndërsa vazhdon të ofrohet me orar furnizimi me ujë në zonat e sipërpërmendura. Gjithashtu nga SH.A UK Vlorë, po përgatitet projekti dhe do të fillojnë procedurat e prokurimit për ndërtimin e depos së re të ujit në Oshëtimë, projekt që do të lidhet me projektin e 15 fshatrave të Nj.A Novoselë dhe punimet do të përfundojnë në vitin 2024, ndërsa pritet që për zonat e targetuara në këtë prioritet të ndryshojë situata, gjatë vitit të ardhshëm.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur për raportin e monitorimit është 45% dhe është prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshteje financiare nga AKUM, tenderim e lidhje kontrate nga bashkia për pjesën e parë të projektit. Gjithësesi kohët e zbatimit të projektit janë të gjata dhe mbetet të shihet për periudhën 2023-2024 nëse do të ketë ndryshime të situatës)**

***Shushicë.*** Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Rrjeti i ujësjellësit është tepër i amortizuar për gjithë Nj. A Shushicë pavarësisht se ka burime shumë të mira ujore. Nga stacioni i pompave tek ish serrat (Shushicë) ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë ka montuar një pompë centrifugale re dhe një pus shtesë në Shushicë, për të rritur sasinë e ujit, si dhe ka pastruar depon në Grabian për furnizimin me ujë sa më cilësor, nga raportimet në terren asgjë nuk ka ndryshuar nga raportet e mëparshme të monitorimit. Banorët vazhdojnë të furnizohen në çezmat kryesore të fshatrave ndërsa uji vazhdon të vijë me orar atje ku janë tubacionet e shtruara.

Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm në këtë njësi, vazhdon të mbetet një prioritet. Asnjë progres nuk është vërejtur në periudhën e monitorimit për Nj.A Shushicë.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20%+ dhe është prioritet i pa realizuar.**

#### **PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET**

- **Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësive vijuese:**

***Rajonet e qytetit Vlorë.*** Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Kryerja e investimeve në zonat periferike të Vlorës është një prioritet që ka gjetur zbatim në vitin e tretë të monitorimit. Projekti i mbështetur nga qeverisja qendrore përmes bashkisë

Vlorë “Ndërtim KUZ, rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë”, ka sjellë ndryshime konkrete në disa zona periferike, ku janë shtruar linjat e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza (zona e Fabrikës së Cimentos, Ujë i Ftohtë, etj). Ky objekt është parashikuar në buxhetin e shtetit për likuidim në vitet 2021-2024. Përmes tij pritet të sistemohet sistemi i kanalizimeve në qytetin e Vlorës.

Duhet të theksojmë se investitori më i madh në këtë prioritet mbetet Qeverisja Qendrore me fonde të buxhetit të shtetit. Aktualisht po kryhen disa investime madhore që po vazhdojnë punimet edhe pse afatet e përfundimit të tyre janë midis 2023-2024. Përmendim edhe projektin tjetër të rëndësishëm përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë. Duke u nisur nga raportimi i vitit të parë të monitorimit theksojmë se këtë verë ka qënë në funksion të plotë impianti i përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit, duke e kthyer zonën e Lungomares në një plazh të frekuentuar nga pushuesit.

Ndërmarrja e UK Vlorë, punën e saj e ka orientuar drejt pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit ekzistues të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, ndërsa ka sjellë rezultate konkrete në eliminimin e përmbajtjeve duke përmirësuar ndjeshëm situatën. Gjithsesi theksojmë se mjaft zona të tjera vazhdojnë të kenë probleme dhe duhet ndërhyrje e vazhdueshme në sektorin e kanalizimeve. Edhe mirëmbajtja dhe pastrimi i kanaleve në lagjet periferike (p.sh kanali i "Naunkës", në lagjen "24 Maji"), duhet të kthehet në një proces periodik nga U.K Vlorë.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ dhe është prioritet i realizuar. Mbetet të monitorohet në vazhdim rezultatet që do të sjellin ndërhyrjet e buxhetuara.**

***Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë.*** Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërnj.

***Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:***

Nuk ka informacione për ndryshim të situatës për vitin e tretë të raportimit, vetëm në KUZ Fitore dhe KUB Novoselë (ujëra të zeza dhe të bardha) janë hartuar projektet që janë pjesë e financimit të projektit të furnizimit me ujë të 15 fshatrave të Novoselës, që pritet të ndërhyhet në vitet e ardhshme. Aktualisht deri në shtator të 2022, nuk ka ndryshim të situatës.

Në Orikum është hartuar projekti për KUZ dhe për vënien në punë të impiantit të ujërave të ndotura, financuar nga FSHZH dhe KFV. Ndërsa për Nj.A Qendrër dhe Shushicë nuk ka rrjet kanalizimesh dhe deri për periudhën e raportimit nuk ka një projekt përfundimtar për ndryshimin e situatës.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi është i njëjtë me atë të vitit të mëparshëm të raportimit 40%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.**

#### PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK

- Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.

Këtij problemi i është dhënë zgjidhje duke i transportuar fëmijët në statusin e pasagjerit në linjë ndërqytetëse që në raportin e parë të monitorimit. Banorët rikonfirmojnë se kjo çështje është e zgjidhur dhe nuk përbën më problem.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.**

#### PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK

- Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00

#### ***Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:***

Sistemi i transportit urban në Vlorë realizohet përmes firmës Urban Trans Vlora, ndërsa transporti në rrjetin e linjave rrethqytetëse, kryhet përmes përdorimit të autoveturave me 8+1 vende (jo taksi) ose shoqëri transporti, në linjat e mëposhtme: Vlorë – Orikum; Vlorë – Llakatund; Vlorë- Babicë dhe së fundmi edhe Vlorë – Novoselë. Oraret kryesisht varrojnë nga ora 7:00-14.00 për nj.a-të, ndërsa në qytet deri në orën 20.00 dhe në verë deri në orën 22.00.

Ndërsa kërkohet reformimi i transportit publik masiv veçanërisht për linjat urbane, ende nuk ka një terminal të caktuar për autobuzët furgonat që kryejnë shërbimin e transportit urban brenda kësaj bashkie, ndërsa ka shumë pak dokumentacion të krijuar nga ana e bashkisë Vlorë, bazuar në rregullore/plane veprimi të reja pas RAT. Nga prioritetet e qytetarëve shërbimi i transportit urban dhe rregullimi i tij, vazhdon të mbetet një nevojë që ka nevojë të adresohet më tepër nga bashkia dhe KB. Ndërsa PPV thekson se paralelisht, mbi bazën e rregulloreve të reja, nevojitet një operim më i përshtatshëm për të gjithë autobusët ekzistues, futja e një linje tjetër shërbimi për autobusët me qëllim që të mbulohen zonat ku aktualisht nuk ka asnjë shërbim dhe të bëhet një koordinim i mundshëm i ndërlidhjes me operatorët e ndryshëm turistik. Gjithsesi nevojitet mbikëqyrje dhe disiplinim të shërbimeve të transportit publik lokal<sup>5</sup> nga shoqëritë private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve, përmes legjendave treguese që janë të aksesueshme nga të gjithë qytetarët). Për këtë qëllim, Qendra Rinore e Vlorës, në muajin shtator 2022, ka ndërmarrë një fushatë advokuese për të përmirësuar këtë shërbim në bashkinë Vlorë. Pjesë e fushatës ishte dhe kërkesa për informim, bazuar në Ligjin Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, më datë 12 shtator 2022, drejtuar Bashkisë Vlorë për të marrë me shumë informacion në lidhje me këtë prioritet të Kontratës Sociale.

<sup>5</sup> <https://euronews.al/kaos-me-transportin-publik-ne-vlore-qytetaret-autobuset-vijne-sipas-qeifit/>

Në përgjigje të kërkesës me **Nr.5 prot. datë 12.9.2022** për transportin publik, në qytetin e Vlorës u kthye përgjigja se Bashkia e Vlorës në bashkëpunim me operatorin "Urban Trans Vlorë", që kryen transportin publik në qytetin e Vlorës për shërbimin urban po **punon për pregatitjen e afisheve në stacionet e autobusave të linjave urbane.**

Ndërsa për transportin rrethqytetës linjat dhe oraret (frekuencat) janë përcaktuar me VKB nr 35. datë 28/04/2022, po ashtu dhe vendqëndrimet për këto linja janë me VKB. Për linjën **Vlorë-Novoselë** në mbledhjen e datës 30.09.22 me **VKB nr 74**, "Mbi një ndryshim në VKB Nr.61 datë 27.10.2016" mbi miratimin e rrjetit të linjave rrethqytetase dhe numrit të orareve për çdo linjë" **u miratua që oraret të jenë nga ora 6.00-18.00, çdo një orë.** Përmes këtij vendimi kjo Njësi do të ketë mundësi tu ofrojë qytetarëve të saj një shërbim transporti që prej vitesh mungonte, ndërsa mbetet ende për tu parë si do të funksionojë ky shërbim në të ardhmen. Gjithsesi çështja e transportit publik për qytetarët do të jetë pjesë edhe e një peticioni që do ti drejtohet bashkisë Vlorë dhe KB dhe do të monitorohet në vazhdimësi edhe nga ana e Qendrës Rinore Vlorë, si pjesë e Kontratës Sociale.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi vlerësohet për periudhën e tretë të monitorimit me 65% nga 50% në raportin e dytë dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.**

#### **PRIORITET NR. 6: PASTRIMI**

- **Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.**

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Projekti i ndërtimit të vend-depozitimit të Sherishtës financohet nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KFW, Qeveria Shqiptare dhe Bashkia Vlorë, në emër të programit Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Vlorë, që vijon nga 2020, ku buxheti i shtetit ka planifikuar gjithsej 695.4 milion lekë, nga të cilat 200 milion janë grant dhe 450 milion janë kredi. Projekti në tërësinë e tij, me të gjithë komponentët pritet të mbarojë në 2023.

Në bashkinë Vlorë i është dhënë rëndësi e veçantë realizimit të këtij projekti duke alokuar më tepër fonde dhe duke shtuar vëmendjen ndaj realizimit të tij. Për këtë qëllim është krijuar Ndërrmarrja Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane MIM e cila ekzekuton dhe përfiton në mënyrë të drejtëpërdrejtë shërbimet nga ky projekt. Në periudhën e raportimit puna e kësaj ndërmarrje është fokusuar në: Ndërtimin e strukturave në qendrën rajonale të MM në Sherishtë dhe së dyti në organizimin e marrjes në dorëzim të pajisjeve dhe mjeteve të reja në kuadër të programit Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Vlorë.

Kapaciteti i venddepozitimit është rreth 1,000,000 m<sup>3</sup> (4 qelizat) i projektuar për një periudhë 20 vjeçare, çka përputhet edhe me përvoja bashkëkohore në këtë fushë, të vendeve më të zhvilluara.

Në kuadër të projektit po ndërtohen qelizat 1 dhe 2 me kapacitet rreth 500,000 m<sup>3</sup> me periudhë shfrytëzimi deri në 15 vjet. Impianiti i venddepozitimit është pjesë e programit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane në Vlorë. Programi përbëhet nga tre komponentë që janë:

1. **Ndërtimi i qendrës së menaxhimit të mbetjeve urbane (përfshirë venddepozitimin)** në afërsi të fshatit Sherishtë (komponenti i parë është aktualisht në zbatim është përfunduar 94% e punimeve nga 70% që ishte në raportin e dytë të monitorimit), me komponentët komplementarë të venddepozitimit sipas kuadrit ligjor dhe standarteve të BE-së. Komponenti i parë përfshiu “Projektin e ndërtimit të qendrës së menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë landfillin, impiantin e ndarjes dhe selektimit të mbetjeve, impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura që gjenerohen nga mbetjet, godinën administrative të ndërmarjes që do menaxhojë qendrën e mbetjeve, magazinën, me vendndodhje në Sherishtë” i cili është investimi i parë infrastrukturor në fushën e trajtimit të mbetjeve urbane në Vlorë. Punimet kanë nisur në Korrik 2020 dhe është drejt përfundimit në muajin shtator 2022. Në këtë fazë është ndërtuar garazhi bashkiak për mjetet e reja të pastrimit të qytetit i cili po ndërtohet pranë fushës aktuale të mbetjeve, ndërsa nuk ka ndodhur ende instalimi i koshave të nëndheshëm në zonën turistike të qytetit “Lungomare” dhe janë kryer rehabilitimi i pikave të koshave në të gjithë territorin e Bashkisë.

2. Gjatë periudhës së monitorimit është realizuar **blerja e makinerive dhe paisjeve për pastrimin e qytetit** (komponenti 2). Menaxhimi i infrastrukturës së re që po ndërtohet duke përfshirë komponentin e dytë të projektit që ka nisur zbatimin në muajin shtator 2021 me blerjen e sistemit të ri të mjeteve për grumbullimin e mbetjeve duke përfshirë koshat dhe makineritë e transportit që janë prezantuar në aktivitet publik më 12 gusht 2022 (<https://bit.ly/3FFpfTm>)

Gjithashtu është punuar edhe për planin e biznesit të ndërmarrjes së MIM me mbështetjen e konsulentëve gjermane, ku përfshihen edhe tarifat për shërbimin e mbetjeve.

3. **Rehabilitimi i vend depozitimeve** ekzistuese të rajonit të Vlorës, ende **nuk ka ndodhur** deri në raportin e tretë të monitorimit. Ky komponent përfshin rehabilitimin e dy fushave të mbetjeve Vlorë dhe Orikum si dhe 10 pikave të tjera të cilat janë përdorur për grumbullim mbetjesh në njësitë administrative. *Bashkia nuk ia doli që këtë proces ta mbyllte gjatë 2022, për shkak të vonësive të krijuara për përfundimin e landfillit sanitar.*

Gjatë periudhës së monitorimit është përgatitur **Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të mbetjeve (PVMIM)**, për të cilin bashkia Vlorë ka ngritur një grup pune. Në datën 29.04.2022 u zhvillua takimi i zgjeruar për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Vlorë, me prezencë të Këshilltarëve Bashkiakë si dhe organizata. Plani është konsultuar me grupe të ndryshme, por ende nuk ka marrë formë zyrtare, të jetë aprovuar nga Këshilli Bashkiak. Projekt-vendimi për PVMIM gjendet në faqen e bashkisë Vlorë<sup>6</sup>, por ende nuk është aprovuar në mbledhjen e KB.

Edhe pse ishte parashikuar që ky prioritet, të paktën për lotin e parë, atë të ndërtimit të landfillit sanitar të përfundonte në fillim të vitit 2022 dhe ndërmarja e MIM raporton se janë kryer pothuajse të gjitha punimet, vepra ende nuk është bërë funksionale për banorët e Vlorës.

<sup>6</sup> <https://vlora.gov.al/projekt-vendim-per-miratimin-e-planit-vendor-te-menaxhimit-te-integruar-te-mbetjeve-bashkia-vlore/>

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 80%+ në periudhën e dytë të monitorimit në 85% + në periudhën shtator 2021-shtator 2022, dhe është prioritet i adresuar drejt realizimit faktik.

## PRIORITET NR. 7: PASTRIMI

- Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:

**Rajonet e qytetit Vlorë.** Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstrukcion (p.sh rruga “Shyqyri Alimerko”). Në pjesën e “Lungo Mares” i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.

### Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021:

Në lidhje me këtë prioritet, kërkesat fillestare të qytetarëve të Vlorës, të pasqyruar në Kontratën Sociale, kanë marrë zgjidhje, në pjesën më të madhe të tyre. Në raportet e mëparshme Qendra Rinore e Vlorës ka bërë një analizë të thelluar si funksionon shërbimi i pastrimit të mbeturinave në qytet dhe Nj.A. Nga monitorimi i dytë rreth 80% e këtyre prioritetëve ishin realizuar. Në **monitorimin e tretë** vlerësojmë se është arritur një progres nga **80% në 90%**, bazuar në arsyetimin më poshtë.

*Shërbimi cilësor dhe shtimi i koshave sidomos gjatë sezonit turistik:* Gjatë periudhës së monitorimit, në bashkinë Vlorë dhe sidomos në qytet janë instaluar kontenierët e rinj, si pjesë e projektit të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Vlorës, mbështetur nga KFW-ja, Qeveria Shqiptare dhe Bashkia Vlorë. Buxheti Bashkiak për menaxhimin e mbetjeve është rreth 3 milion euro ose 15.5% e buxhetit të përgjithshëm. Rreth 30% mbulohet nga tarifat e ekonomive familjare dhe njësisive tregtare/biznesi, ndërsa pjesa tjetër prej financohet nga buxheti i përgjithshëm i bashkisë. Gjatë vitit 2022, nën varësinë e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike (DIIP - drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve), dy ndërmarrje të Bashkisë Vlorë, ajo e Shërbimeve Publike dhe MIM Vlorë kanë administruar çështje që lidhen me menaxhimin e mbeturinave. Nuk është e qartë si ndahen rolet dhe përgjegjësitë midis tyre, por stafi i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është parë në të gjitha aksionet e pastrimit në qytet, të cilat kanë qënë të shumta, ndërsa është punuar me mjetet e ndërmarrjes së MIM Vlorë dhe janë pastruar mjaft pika të ndotura në qytet gjatë gjithë vitit 2022.

Së fundmi, ndihmuar edhe nga programi për menaxhimin e mbeturinave në Qarkun e Vlorës, bashkia e Vlorës së bashku me dy ndërmarrjet e saj të varësisë është duke ndryshuar gjithë filozofinë e saj për menaxhimin e mbetjeve urbane. KB ka miratuar disa vendime që kanë të bëjnë me oraret e hedhjes së mbetjeve urbane si dhe vend depozitimet e tyre, si dhe miratim të masave administrative ndërshkuese për qytetarët dhe kryesisht për bizneset duke ndryshuar dhe tarifat e pastrimit në buxhetin vendor për 2022. *Theksojmë se Bashkia Vlorë e ka kthyer në*

*prioritet të saj pastrimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e saj përgjatë periudhës shtator 2021-shtator 2022.*

Gjithësesi përplasjet midis bashkisë dhe KB, kanë vazhduar duke penguar procese të veçanta të menaxhimit të mbetjeve urbane, (kryesisht për punësimin e stafit që do të punojë në landfillin e Sherishtës). Gjatë kësaj periudhe të monitorimit vendepozitimi aktual i mbeturinave është përfshirë nga flakët, më datë 4 tetor 2021, që sipas kryetarit të bashkisë është cilësuar si zjarrëvënie e qëllimshme<sup>7</sup> dhe në një tjetër episod në muajin korrik 2022.

Shërbimi i pastrimit në territorin e Bashkisë Vlorë realizohet me kompani private. Aktualisht këtë shërbim e realizojnë tre kompani nga të cilat një në qytet dhe dy në Nj.A të Vlorës. Me fonde të saj bashkia Vlorë ka kontraktuar “Duka” shpk që realizon pastrimin e qytetit të Vlorës. Kjo kontratë parashikon shërbimet për menaxhimin e mbetjeve që aktualisht përfshijnë heqjen e mbetjeve urbane dhe inerte, fshirjen dhe larjen e rrugëve, vendosjen e koshave për dorëzimin e mbetjeve, pastrimi i rrugëve, shesheve si dhe mirëmbajtja e vend grumbullimit të mbetjeve. Kontrata për pastrimin e qytetit është 3 vjeçare me shoqërinë Duka shpk, ndërsa gjatë vitit të tretë të monitorimit Bashkia Vlorë, i ka kërkuar kësaj firme të rrisë performancën, kjo nga kontrollet që bashkia ka realizuar dhe përmes informacioneve dhe ankesave të qytetarëve, i është kërkuar të korrigojen faturat për të kryer likuidimet. Gjatë periudhës së raportimit, çështja ka kaluar në gjykatë dhe është hapur çështje gjyqësore me subjekt "Duka" shpk kundrejt Bashkisë Vlorë dhe pritet të ketë një vendim mbi problematikën e hasur gjatë zbatimit të kontratës për pastrimin e qytetit të Vlorës. Në muajin gusht 2022, kryebashkiaku Leli u gjobit nga AKM për keqmenaxhim të mbetjeve në sezonin turistik<sup>8</sup>. Në një prezantim publik ku u prezantuan makineritë e reja për pastrimin e Vlorës, Kryetari i Bashkisë, kërkoj penalizimin e firmës Duka<sup>9</sup>, si përgjegjëse për situatën e krijuar ndërsa vetë bashkia me stafin e saj u angazhua maksimalisht gjatë muajit gusht për ndryshimin e situatës së menaxhimit të mbetjeve urbane në qytet. Edhe firma Duka u përgjigj përmes një komunikimi<sup>10</sup> duke bërë përgjegjëse bashkinë Vlorë që nuk ka kryer pagesat për këtë shërbim. Situata u përmirësua ndjeshëm pas reagimeve, ndërsa qytetarët kanë evidentuar të dyja subjektet Bashkinë dhe firmën Duka, të realizonin heqjen dhe transportimin e mbeturinave urbane në muajin gusht.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ nga 80% që ka qënë në vitin e mëparshëm të raportimit dhe është prioritet i realizuar.**

**Novoselë.** *Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.*

<sup>7</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/katastrofe-mjedisore-ne-vlore-perfshihet-nga-flaket-fusha-e-mbetjeve-urbane-ne-vlore>

<sup>8</sup> <https://euronews.al/kryebashkiaku-i-vlores-dritan-leli-gjebet-per-keqmenaxhimin-e-mbetjeve/>

<sup>9</sup> <https://www.balkanweb.com/dritan-leli-i-merr-vete-punet-ne-dore-i-heq-licencen-firmes-se-pastrimit-dhe-prezanton-floten-e-makinave-te-teknologjise-se-fundit/>

<sup>10</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/leli-kerkoi-ti-liqej-licenca-firma-e-pastrimit-prej-1-viti-bashkia-nuk-derdh-asnje-gindarke-per-sherbimin-e-pastrimit-do-paragesim-faktet-para-organeve-ligjzbatuese>

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Falë mbështetjes së projektit për MIMU, Nj.A Novoselë përfitoi duke u pajisur me 137 kosha të rinj ose të përdorur që u transferuan nga Vlora drejt kësaj njësie. Njësia administrative Novoselë ka 95 pika të grumbullimit të mbetjeve ku janë të instaluar së fundmi në total 137 kontenierë në hapësirën e 12 fshatrave, që mbulon një sipërfaqje prej 254,000 m<sup>2</sup>.

Ndërkohë që nga një shërbim që kryhej nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe vetë njësia administrative Novoselë, ky shërbim është tenderuar dhe Bashkia Vlorë ka lidhur kontratën nr.6483 prot datë 30.07.2020 me shoqërinë “REJ” sh.p.k. me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Qendër, Novoselë, Shushicë të Bashkisë Vlorë”, që ka filluar zbatimin më datë 01.08.2020, me afat 32 muaj.

Operatori privat grumbullon mbetjet urbane 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Transportimi i tyre bëhet drejt vendgrumbullimit kryesor të bashkisë Vlorë në Jalli, në sasinë rreth 467 tonë/muaj. Nga komunikimet me përfaqësues të njësisë dhe qytetarë vlerësohet ndryshimi pozitiv i situatës, ndërsa gjatë periudhës së monitorimit edhe NSHP ka pastruar pika të caktuara të kësaj njësie që prej vitesh nuk pastroheshin. Ndërsa funksionimi i landfillit pritet të përmirësojë ndjeshëm situatën.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70+%, krahasuar me 30% që ka qenë në periudhën e dytë të monitorimit dhe është prioritet i realizuar.**

**Orikum.** Vendosije e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dezinfektimi i koshave ekzistues. Eliminimi i plotë i djegies së mbeturinave.

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Shërbimi i pastrimit të Nj.A Orikum realizohet nga firma “Baitel” sh.p.k. që ka fituar tenderin 3-vjeçar nga Bashkia e Vlorës. Në këtë Nj.A grumbullimi i mbeturinave bëhet në 215 konteniere ose pika grumbullimi. Edhe Nj.A Orikum ka përfituar nga shpërndarja e kontenierëve që janë transferuar nga Bashkia e Vlorës, por nuk kemi të dhëna nëse ato janë vendosur në vendet e caktuara apo janë të magazinuara. Në qytet mbetjet largohen nga çdo kontenier gjatë natës, ndërsa në fshatrat e kësaj njësie, për shkak të sasisë më të vogël të mbetjeve, grumbullimi i tyre kryhet në ditë të caktuara të javës sipas një grafiku të miratuar për t’iu përshtatur terrenit dhe trafikut të rënduar në zonën turistike. Transporti i mbetjeve kryhet nga qyteti i Orikumit dhe fshatrat e njësisë për në vendgrumbullimin e Orikumit.

Mbetjet e grumbulluara nga qyteti i Orikumit dhe fshatrat e tjerë të njësisë transportohen dhe depozitohen në vendgrumbullimin e Orikumit, i cili ndodhet rreth 380 m në juglindje të qytetit. Edhe pse ishte premtuar që ky vend depozitim do të mbyllej dhe mbetjet do të trajtoheshin në Sherishtë, ende nuk është realizuar mbyllja e venddepozitimit. Ndërsa nuk ka patur raste të djegies së mbeturinave në venddepozitim gjatë periudhës së verës.

Gjithsesi qytetarët e njësisë administrative Orikum vazhdojnë të kenë shqetësime në lidhje cilësinë e pastrimit në qytet dhe fshatrat që ndodhen përgjatë zonës turistike, që kanë nevojë për vëmendje të shtuar gjatë sezonit të verës. Gjithashtu ka nevojë të dezinfektohen të gjithë



kontenierët e mbeturinave, ndërkohë që dezinfektohen vetëm disa prej tyre në qendër të qytetit.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 30% + nga 20%+ që ishte në vitin e dytë të monitorimit dhe është prioritet i pa realizuar.**

***Qendër Vlorë.** Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.*

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Bashkia Vlorë ka arritur të përmbushë një prej kërkesave të banorëve, shërbimi në këtë Njësi Administrative kryhet me operator privat, përmes kontratës me shoqërinë “REJ” sh.p.k. me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Qendër”, që ka filluar nga zbatimi më datë 01.08.2020. Në këtë njësi administrative janë të shpërndara 30 pika grumbullimi/kontenierë. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve nga familjet dhe bizneset përgjatë bregdetit Nartë–Zvërnec kryhet çdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. NSHP e bashkisë ka ndërhyrë përmes pastrimit të vendepozitimeve të mbeturinave duke u fokusuar të pikat në vende turistike apo të rrugëve lidhëse të kësaj njësie. Gjithashtu janë transferuar edhe disa kontenierë nga bashkia Vlorë.

Pastrimi dhe transporti i mbeturinave bëhet 3 ditë në javë në të 13 fshatrat e kësaj Nj.A edhe pse distancat e secilit fshat nga pika e grumbullimit të mbeturinave në Vlorë janë të largëta, gjithësesi banorët shprehen të kënaqur që ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50% dhe është prioritet në progres për tu realizuar.**

***Shushicë.** Urgjente shtimi i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.*

#### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Heqja dhe transporti i mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar, realizohet nga firma e kontraktuar prej gushtit të 2020, 3 ditë në javë, ndërsa punëtoret e pastrimit sipas bashkisë heqin mbeturinat e lokaleve dhe familjeve që ndodhen në fshatrat e Njesisë Administrative Shushicë. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina do të kryhet transporti i tyre në pikën e hedhjes të caktuar së mbeturinave 10 herë në muaj. Bashkia Vlorë e ka kontraktuar këtë shërbim me qëllim ofrimin e shërbimit sa më të mirë për banorët e kësaj njësie. Edhe në këtë njësi janë pastruar nga NSHP të bashkisë mjaft vendepozitime mbeturinash që gjendeshin prej vitesh në rrugët lidhëse të kësaj njësie, si dhe janë shpërndarë kosha nga bashkia.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50% krahasuar me 40% që ishte në vitin e dytë të monitorimit dhe është prioritet në progres për tu realizuar.**

## PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.**

### Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:

Bashkia Vlorë, vazhdon edhe në këtë vit të tretë të monitorimit të lehtësojë informacionin dhe shpërndarjen e tij për programet mbështetëse që qeverisja qendrore ka aktivizuar përmes ministrisë së bujqësisë. Në qytet përmes nën/kryetares së bashkisë dhe Nj.A nga administratorët dhe agronomët e tyre janë shpërndarë informacione dhe dokumente për të aplikuar në programe të ndryshme. Bashkia përmes mediave sociale ka promovuar ose ka lidhur fermerë ose biznesmenë të ndryshëm që punojnë në fushën e bujqësisë, për të promovuar produktet e në panaire brenda dhe jashtë vendit. Gjithsesi nuk ka të dhëna rreth numrit të përfituesve nga shërbimet e ndërmjetësimit të ofruara nga bashkia Vlorë, ndërsa rekomandohet që ky sektor të riorganizohet dhe të mbështetet me fonde dhe burime njerëzore, për të orientuar zhvillimin ekonomik të qytetarëve nga bujqësia ose agro-ekonomia. Gjithashtu bashkia e Vlorës aktualisht ka ngritur Grupin Vendor të Veprimit për zonën Novoselë dhe Qendër (VJONA LAG) dhe është duke punuar me anëtarët e tij e partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për fuqizimin e tij.

Duhet theksuar se në të dhënat makroekonomike të bashkisë Vlorë, sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programet e saj i fokuson në : 1. Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve; 2. Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit; 3. Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave. Bazuar mbi keto programe investimet e saj për vitin 2022 janë në riskonstruksionin e hidrovoriit të Akërnisë si dhe pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese.

Ndërsa në lidhje me përfundimin e procesit të menaxhimit të tokave, vazhdohet te ecet me ritme të ulta, edhe pse nevojat vazhdojnë të jenë të larta nga qytetarët. Përsheptimi i këtij procesi ndikon edhe në programin e mbështetjes së fermerëve, të cilët mund të aplikojnë për mbështetje nga fondet e AZHBR-së për mbështetje financiare.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur për raportin e tretë të monitorimit është 80%+ nga 70% ne raportin e dytë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar.**

## PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.**

### Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:

Për periudhën shtator 2021-shtator 2022, është vënë re progres nga ana e drejtorisë së të ardhurave vendore, duke rritur performancën e saj në mbledhjen e taksave dhe tarifave

vendore. Komunikime të vazhdueshme në mediat sociale, lokale apo dhe në takimet ballë për ballë janë realizuar për të informuar qytetarët dhe bizneset lokale. Vlerësojmë përpjekjet e vazhdueshme të kësaj drejtorie që ndër të tjera edhe me stafin e Qendrës Rinore ka mbajtur komunikime të vazhdueshme për mënyrat si mund të lehtësohet komunikimi me qytetarët. Ndërsa sektori i biznesit shfaq pakënaqësitë e tij për moskonsultimin e rritjes së tarifës vendore të pastrimit, në projekt-buxhetin e 2022. Njoftimet përmes postës elektronike për detyrimet ndaj Bashkisë ishte një masë efektive për mbledhjen e taksave ndërsa rekomandojmë që pagesa e taksave dhe tarifave të përkthehet në shërbime cilësore për qytetarët, ata që paguajnë rregullisht të marrin investime nga ana e bashkisë Vlorë.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur në vitin e tretë të monitorimit është 70%+ dhe është prioritet i realizuar**

#### **PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK**

- **Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.**

#### ***Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:***

Gjatë monitorimit të periudhës, raportojmë se bashkia Vlorë, ka kryer disa pagesa për laboratorin e turizmit, bazuar në urdhërin e brendshëm të saj, nr.65 datë 24.03.2021 dhe VKB nr.75 dt 01.10.2020 VKB në mbështetje të marrëveshjes e bashkëpunimit mes shoqatës Bashkimit të Biznesit të Shqipërisë - Biznes Albania “Për funksionimin e laboratorit të turizmit (SET-TOUR LAB)”, për realizimin e trajnimeve në Laboratorin e Turizmit. Pas muajit nëntor 2021, laboratori nuk ka ofruar më kurse edhe pse gjatë verës së 2022, sektori i turizmit në Vlorë u përball me një mungesë të theksuar stafi të trajnuar e kryesisht të rinj për të punuar në këtë sektor.

Gjithashtu edhe pagesa për transportin e grave dhe vajzave që kishte vite që paguhej nga bashkia Vlorë është ndërprerë.

Mbetet për tu monitoruar në vazhdimësi mbi shërbime të reja konkurruese që bashkia mund të ofrojë në këtë sektor duke e matur edhe me numrin e përfituesve që përfitojnë nga ky shërbim.

**Në lidhje me këtë prioritet situata paraqitet e njëjtë dhe vlerësohet me të njëjtën rezultat si vitin e kaluar 60%+ dhe është prioritet i realizuar pjesërisht.**

#### **PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE**

**Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:**

- *mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;*

- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;
- mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;
- raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Bashkia Vlorë vlerësohet pozitivisht për realizimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Ajo ka përmirësuar implementimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, përmes realizimit të dëgjësive të hapura të dokumentuara me rregjistrime dhe publikime në mediat sociale dhe lokale, ndërsa vazhdon të konsolidojë efektivitetin e këtij mekanizmi. Në muajin shtator 2022, bashkia ka realizuar 9 dëgjesa në cdo njësi administrative dhe rajon të qytetit, ndërsa është vënë re pjesëmarrje e ulët qytetare.

Bashkia e asistuar edhe nga qendra Rinore e Vlorës, përdor edhe metoda alternative të mbledhjes së perceptimeve dhe prioriteteve online, përmes anketimit të qytetarëve. Për vitin 2022 rreth 642 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit të ri vendor.

Mbetet ende për të bërë, lidhur me detyrimet ligjore për zbatimin e ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, gjithsesi vlerësohet si progres pozitiv realizimi i këtij prioriteti.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është në të njëjtën vlerë 90%+ dhe është prioritet i realizuar**

### **PRIORITET NR.12: DEMOKRACIA VENDORE**

- **Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.**

### **Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2021 – shtator 2022:**

Bazuar në ndryshimet ligjore të Ligjit për Rininë, bashkia Vlorë hapi thirrjen për anëtarë të Këshillit Vendor të Rinisë në muajin korrik 2022, përmes një thirrje në faqen e saj të webit dhe në mediat sociale. Ngritja e Këshillit Vendor të Rinisë u bë, më 3 gusht 2022. Pas krijimit të këtij këshilli do të monitorohet veprimtaria e tij, duke shpresuar që do të jetë një strukturë funksionale në mbështetje të rinisë vlonjate.

**Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70%+ dhe është prioritet drejt realizimit përfundimtar.**

## Referenca

Faqja zyrtare e bashkisë Vlorë <http://vlora.gov.al/>

Faqja zyrtare e Këshillit të Bashkisë <http://vlora.gov.al/category/degjesat-publike/>

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2022 <http://vlora.gov.al/ep-content/uploads/BUXHETI-2021-VENDIM.pdf>

Kontrata Sociale Vlorë <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Drafti i Planit Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve [https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/PVMIM-Vlore-11.05.2022-4Deputy-Mayor-and-MIM\\_compressed-1.pdf](https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/PVMIM-Vlore-11.05.2022-4Deputy-Mayor-and-MIM_compressed-1.pdf)

Prioriteti 6 dhe 7 i Kontratës Sociale në media: <https://www.balkanweb.com/dritan-leli-i-merr-vete-punet-ne-dore-i-heq-licencen-firmes-se-pastrimit-dhe-prezanton-floten-e-makinave-te-teknologjise-se-fundit/>

Ecuria e prioritetit 6- në media: <https://www.reporter.al/2022/05/26/njera-kembe-e-meduzes-kostot-dhe-perfitimet-e-landfillit-te-ri-te-vlores/>

Prioriteti 12: <https://vlora.gov.al/thirrje-publike-per-keshillin-vendor-rinor/>

## ANEKS

Tabela krahasuese e monitorimit të progresit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

PRIORITETI	Periudha Gusht 2019- Gusht 2020	Periudha Shtator 2020- Shtator 2021	Periudha Shtator 2021- Shtator 2022	Realizimi
<b>PRIORITET 1: Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit..</b>	50%	70%	78%	Progres i adresuar pjesërisht
<b>Për rajonet e qytetit Vlorë.</b> I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosi e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.	50%	70%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Novoselë.</b> Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skrofofinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë	100%	100 %	100%	Prioritet i realizuar
<b>Orikum.</b> I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Rradhimës dhe të Thilpetit.	10%	30%	30%	Prioritet i pa realizuar
<b>Qendër Vlorë.</b> Kërkohet ndërhyrje urgjente në rruget lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.	40%	70%	90%	Prioritet i realizuar
<b>Shushicë.</b> Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në	50%	80%	90%	Prioritet i realizuar

<i>Shushicë.</i>				
<b>PRIORITET 2:</b> Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për	36%	56%	64%	<b>Prioritet i adresuar pjesërisht</b>
<b>Rajonet e qytetit të Vlorës.</b> Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm	50%	70%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Novoselë.</b> Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin vecanërisht gjatë verës.	20%	60%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Orikum.</b> Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.	80%	90%	95%	Prioritet i realizuar
<b>Qendër.</b> Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babiçë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.	10%	40%	45%	Prioritet i pa realizuar
<b>Shushicë.</b> Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.	20%	20%	20%	Prioritet i pa realizuar
<b>PRIORITET 3:</b> Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njëjësive vijuese:	60%	65%	65%	<b>Prioritet i adresuar pjesërisht</b>
<b>Rajonet e qytetit Vlorë.</b> Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.	80%	90%	90%	Prioritet i realizuar
<b>Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë.</b> Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërnj.	40%	40%	40%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>PRIORITET 4:</b> Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.	100%	100 %	100 %	<b>Prioritet i realizuar</b>
<b>PRIORITET 5:</b> Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti	50%	50 %	65%	<b>Prioritet i adresuar pjesërisht</b>

dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00				
<b>PRIORITET 6:</b> Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë	50%	80%	85%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>PRIORITET 7:</b> Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:	20%	42%	58%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.</b>	80%	80%	90%	Prioritet i realizuar
<b>Novoselë.</b> Vendosija e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.	0%	30%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Orikum.</b> Vendosija e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues. Eliminimi i plotë i diegjes së plehrave	10%	20%	30%	Prioritet i pa realizuar
<b>Qendër Vlorë.</b> Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.	10%	40%	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>Shushicë.</b> Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çepirat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.	10%	40%	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>PRIORITET 8:</b> Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.	50%	70%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>PRIORITET 9:</b> Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.	10%	40%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht



<b>PRIORITET 10:</b> Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.	10%	60%	60%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>PRIORITET 11:</b> Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:  <i>-mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;</i> <i>- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;</i> <i>-mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;</i> <i>-raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.</i>	80%	90%	90%	Prioritet i realizuar
<b>PRIORITET NR.12:</b> Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.	50%	60%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<b>TOTALI</b>	<b>47,17%</b>	<b>65,25%</b>	<b>73.75%</b>	<b>Prioritete të adresuara pjesërisht</b>